



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Çështjet Ligjore,
Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë më 11.07.2024

RAPORT

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË PËR VITIN 2023**

I. Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 05 qershor 2024, në zbatim të nenit 148/b shkronja (d), të Kushtetutës, nenit 38, pika 2, shkronja (d), e nenit 204, pika 1, gërma “d”, e ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar, nenit 103 të Rregullores së Kuvendit, dhe të Vendimit, nr.134/2018, si dhe neneve 18, dhe 103 të Rregullores së Kuvendit, mori në shqyrtim “Raportin për veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për Vitin 2023”.

Raporti vjetor pasqyron në vija të përgjithshme gjithë aktivitetin e institucionit, arritjet dhe problematikat e konstatuara dhe analizën e punës për vitin 2023.

Përmbledhja e Raportit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2023, u prezantua nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë Z. Tartar Bazaj.

II. Baza Ligjore

Në zbatim të nenit 148/b shkronja (d), të Kushtetutës, nenit 38, pika 2, shkronja (d), e nenit 204, pika 1, gërma “d”, e ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar, nenit 103 të Rregullores së Kuvendit, dhe të Vendimit, nr.134/2018, si dhe neneve 18,

dhe 103 të Rregullores së Kuvendit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka paraqitur “Raportin për veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për Vitin 2023”.

Komisioni përgjegjës, bazuar në nenin 103, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, organizoi seancën dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe në përfundim të diskutimeve hartoi një projekt-rezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, të cilën ia paraqet seancës plenare.

Projektrezoluta përfshin vlerësime dhe konstatime lidhur me veprimtarinë e institucionit të pavarur, në rastin konkret të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2023 si dhe rekomandime, të cilat institucioni i pavarur duhet t’i realizojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, për vitin 2024.

III. *Diskutimi në Komision*

Gjatë diskutimeve në komision Z. Bazaj prezantoi raportit vjetor. Relatori e çështjes, i caktuar nga komisioni, Z. Saimir Hasalla parashtroi mendimin mbi raportin, dhe vlerësoi veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë gjatë vitit 2023. Z. Hasalla i drejtoi disa pyetje Anëtarëve të Këshillit lidhur me aspekte të veprimtarisë së tij.

Pas diskutimeve dhe pyetjeve të deputetëve, u konstatuan disa arritje dhe problematika të këtij institucioni. U vlerësua angazhimi i Këshillit të Lartë i Prokurorisë në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë të drejtuesve të zyrave të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe të përzgjedhjes së prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme. U diskutua që Këshilli të duhet të angazhohet për të zhvilluar një metodologji të përshtatshme për menaxhimin e stokut si dhe për të rritur bashkëpunimin ndërinstytucional me organet e drejtësisë dhe veçanërisht me Këshillin e Lartë Gjyqësor. U vlerësua tepër i rëndësishëm përfundimi i procesit të vlerësimit vjetor profesional i prokurorëve.

Sipas Komisionit KLP duhet të jetë më aktiv dhe të identifikojë tema për inspektime tematike që do t’i paraqiten Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, si dhe të rrisë bashkëpunimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë sa i përket komandimit të inspektorëve magjistratë. U diskutua mbi nevojën për një plan për komunikimin dhe transparencën, për të nxitur mirëkuptimin dhe besimin e publikut në reformën në drejtësi si dhe për nevojën për digjitalizimin e arkivave dhe sistemeve.

Sa më sipër u sugjerua që të reflektohen në projektrezolutën që do miratohej nga Komisioni për vlerësimin e veprimtarisë për vitin 2024.

Në mbledhjen e datës 03 korrik 2024, Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, mori në shqyrtim projektrezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2024”.

IV. *Përfundime*

Në përfundim të mbledhjes, Komisioni miratoi projektrezolutën me votat pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje dhe ia paraqet për miratim seancës plenare, sipas variantit që i bashkëlidhet këtij raporti.

RELATOR

Saimir HASALLA

KRYETARE

Klotilda BUSHKA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

MIRATOHET

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA

PROJEKTREZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË PËR VITIN 2023**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

- Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në garantimin e pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë;
- Duke nënvizuar rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë, transferimin dhe vendosjen e masave disiplinore, si dhe pezullimin e prokurorëve të të gjitha niveleve;
- Duke mbajtur në konsideratë rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në miratimin e standardeve të etikës së prokurorëve dhe të rregullave të sjelljes së prokurorëve, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të tyre;
- Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin vazhdues të prokurorëve dhe emërimin e prokurorëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës;
- Duke mbajtur parasysh rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorit;

Për veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për vitin 2023 konstaton se:

- Këshilli i Lartë i Prokurorisë është angazhuar në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë të drejtuesve të zyrave të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe të përzgjedhjes së prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme.
- Ka trajtuar brenda afateve ligjore çështjet e paraqitura për trajtim nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar Rregulloren për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve, programin që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi, planin tre-mujor të vlerësimit dhe ka caktuar me short relatorët dhe këshilltarët ligjorë përgjegjës për procedurën e vlerësimit të prokurorëve dhe pritet fillimi i procesit të vlerësimit.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë kërkon që Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për vitin 2024, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht dhe në këto drejtime:

1. Të përfundojë vlerësimin vjetor profesional të prokurorëve, duke hartuar raportet analitike të vlerësimit dhe të raportojë për mbarëvajtjen e procesit të hartimit të raporteve analitike të vlerësimit etik dhe profesional, brenda muajit dhjetor 2024.
2. Të angazhohet maksimalisht në plotësimin e vakancave të përkohshme dhe të përhershme të prokurorëve, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe atë të posaçme.
3. Të unifikojë raportimet dhe hedhjen e të dhënave (duke marrë shkas nga vështirësitë e hasura mbi plotësimin e formateve të reja mbi të dhënave statistikore për vlerësimin profesional dhe etik të prokurorëve), duke koordinuar përpjekjet për unifikimin e raportimeve dhe hedhjen e të dhënave në të gjithë sistemet e administrimit, përfshirë regjistrat elektronikë dhe manualë.
4. Të hartohen indikatorët e performancës së prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm bazuar në të dhënat e aneksit nr. 2 të Rregullores si dhe të përcaktohen indikatorët e performancës së prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, bazuar në aktet në fuqi.
5. Të bashkërendojë punën me Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke intensifikuar takimet për të adresuar problematikat e përbashkëta dhe për të siguruar një qasje të përbashkët në sfidat që lidhen me sistemin e drejtësisë; me fokus në plotësimin e vakancave në gjykata, prokurori dhe ILD si dhe në zhvillimin e sistemeve teknologjike.
6. Të hartohet një metodologji dhe të ndërmerren hapa konkrete për të zvogëluar stokun e prapambetur në të gjithë nivelet.
7. Të hartohet një raport mbi problematikat e evidentuara, gjatë kohës së funksionimit të Këshillit, të paraqitet në Kuvend deri në dhjetor 2024.
8. Të rritet bashkëpunimi me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, sa i përket identifikimit të inspektimeve tematike, komandimit të inspektorëve magjistratë, si dhe të krijohen mekanizma për të përmirësuar komunikimin dhe koordinimin për të adresuar çështjet disiplinore dhe etike në sistemin e prokurorisë.
9. Të vijojë bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës, për emërimin dhe caktimin në detyrë të prokurorëve të rinj, verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve që aplikojnë për

t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar dhe miratimin e kalendarëve të trajnimeve vazhdues të prokurorëve.

10. Të merren masa për digjitalizimin e arkivave të sistemit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë si dhe të bashkëpunojë me Prokurorin e Përgjithshëm për ruajtjen, sistemimin dhe digjitalizimin e arkivave të sistemit të prokurorisë në tërësi.
11. Të angazhohet në përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritit në Bashkimin European.

Miratuar në datën _____.2024